



EASO

Rekoma ndime praktike lidhur me kryerjen e regjistrimit në distancë/onlajn (depozitimi)

*Seri udhëzimesh
praktike të EASO*

Qershor 2020



Dokumenti i përfunduar në qershor 2020 Janë bërë korrigjime në korrik 2020, në faqet 10-11.

As EASO, as ndonjë person që vepron në emër të EASO nuk është përgjegjës për përdorimin që mund t'i bëhet informacioneve të mëposhtme.

Luksemburg: Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, 2020

© European Asylum Support Office, 2020

PDF ISBN 978-92-9400-330-0

doi:10.2847/753272

BZ-02-20-395-SQ-N

Cover page image, juststock, © iStock, 2017

Riprodhimi autorizohet me kusht që të bëhet i ditur burimi. Për çdo përdorim ose riprodhim të fotografive ose të materialeve të tjera për të cilat të drejtat e autorit nuk i ka EASO, duhet të kërkohet leje direkt nga zotëruesit e të drejtave të autorit.



Rekomandime praktike lidhur me drejtimin e regjistrimit në distancë/onlajn (akomodimi)

Informacion rreth udhëzuesit

Ky udhëzues i shkurtër është zhvilluar si rezultat i takimeve tematike të mbajtura nga Rrjeti i Proceseve të Azilit EASO. Përpilimi i tij është ndërtuar në burimet e mëposhtme:

- Informacioni i ofruar nga shtetet e BE+ për kryerjen e regjistrimit onlajn;
- Mjete praktike EASO, ku përfshihen:
 - [Udhëzime nga EASO për procedurën e azilit: standardet operacionale dhe treguesit;](#)
 - [Udhëzues praktik i EASO: intervistë personale;](#)
 - [Udhëzues praktik i EASO: vlerësim i provave;](#)
 - [Mjeti EASO për identifikimin e personave me nevoja të veçanta](#)
 - [Rekomandimet praktike të EASO për intervistën personale në distancë](#)

Ky udhëzues është zhvilluar gjatë një periudhe kritike të dominuar nga masat e distancimit social që u kërkohen administratorëve si pasojë e situatës së krijuar nga COVID-19. Megjithatë, ky udhëzues nuk kufizohet vetëm në këtë kontekst, por ai sheh praktikatat e mira që mund të jenë të dobishme përtej situatës së COVID-19.

Qëllimi i këtij udhëzuesi është që të ofrojë rekomandime praktike për mënyrën se si të prezantohen elementët e distancës, onlajn ose IT në procesin e regjistrimit për ta bërë procesin e përgjithshëm më të efektshëm dhe më të organizuar. Përveç kësaj, duke u bazuar në standardet operacionale dhe në treguesit e në praktikatat e mira, ky dokument tregon masat mbrojtëse procedurale dhe rekomandimet praktike që autoritetet e azilit mund të shqyrtojnë kur mundësojnë regjistrimin e aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare onlajn/në distancë.



Përmbajtja

Informacion rreth udhëzuesit	3
I. Hyrje	5
II. Ndikimi që pati situata e COVID-19 në sistemet e regjistrimit	6
III. Sigurimi i informacionit	9
IV. Regjistrimi paraprak (dhe sistemet e takimit)	11
V. Shenjat e gishtave në Eurodac	13
VI. Vetëregjistrimi.....	16
VII. Mbledhja e të dhënave në distancë.....	17
VIII. Roli i madh i qendrave të recepcionit në procesin e regjistrimit.....	19



I. Hyrje

Në shtetet e BE+ ⁽¹⁾, aplikimet për mbrojtje ndërkombëtare zakonisht regjistrohen në praninë e aplikuesit. Regjistrimet në distancë të bëra jashtë premisave të autoriteteve përgjegjëse janë raste të veçanta. Në shumicën e rasteve, regjistrimet në distancë janë vetëm për njerëzit që nuk mund të paraqiten vetë në zyrën e posaçme (p.sh. aplikuesit në burg ose të shtruar në spital).

Shtetet e BE+ përfshijnë autoritete përgjegjëse të ndryshme në procesin e regjistrimit. Të dhënat personale mblidhen në hapa të ndryshëm nga aksionarë të ndryshëm. Disa prej informacioneve mund të mblidhen në distancë në praninë e aplikuesit, ndërsa aspekte të tjera (p.sh. mbledhja e të dhënave biometrike) kërkon praninë fizike.

Pas masave kufizuese të vendosura në mars 2020 për të luftuar emergjencën shëndetësore COVID-19, shumica e shteteve të BE+ kanë vendosur kufizime kufitare, të cilat kanë shkaktuar rënie të konsiderueshme në numrin e aplikuesve të sapoardhur. Ndërkohë që aktivitetet e regjistrimit po pakësoheshin, administratorët u përqendruan te përpunimi i regjistrave të tyre.

Teksa hasën pakësime të kapaciteteve të regjistrimit gjatë fluksit të vitit 2015, disa shtete filluan të zhvillonin mjete për t'u përballur me faktin që regjistrimi ishte një ngadalësim i madh në procedurën e azilit. Edhe pse këto mjete mund të kufizojnë deri në njëfarë mase nevojat për bashkëveprim social mes pjesëmarrësve të procesit të regjistrimit, ato nuk kanë synojnë një metodë krejt digjitale të eliminimit të kontaktit fizik me aplikuesin.

Ky udhëzues përqendrohet te praktikat e mira dhe mjetet e dobishme për regjistrimin në distancë ose onlajn në përgjithësi. Edhe pse është e rëndësishme të sigurohemi për vazhdimësinë e biznesit në rastin e nevojës për distancim social në aspektin afatgjatë, ose për të qenë të përgatitur për raste të papritura, regjistrimet në distancë sigurojnë gjithashtu një mënyrë për modernizimin e infrastrukturave për azil.

Aktualisht, EASO është duke shfrytëzuar zgjidhje novatore për të adresuar sfidat e ardhshme me qëllim që të shmangen problemet e regjistrimit dhe të sigurohet një mënyrë alternative që bën të mundur distancimin social. Në këtë proces, EASO mbështetet më tej te mjetet praktike të zhvilluar edhe të testuara me sukses në Shtetet e BE+.

(¹) Shtetet e BE+ janë Shtete Anëtare të Bashkimit Evropian plus Norvegjia dhe Zvicra.

II. Ndikimi që pati situata e COVID-19 në sistemet e regjistrimit

Në përgjithësi, nën masat që rregullojnë situatën e COVID-19, shumica e shteteve të BE+ kanë vazhduar regjistrimin e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare. Disa shtete kanë raportuar ndërprerje ose pezullim të përkohshëm të aktiviteteve të tyre të regjistrimit.

Ekzistojnë rrugë të ndryshme të zgjedhura nga shtetet përkatëse të BE+ për t'u përballur me situatën e COVID-19:

- duke përdorur të njëjtën metodë regjistrimi gjatë aplikimit për masa të jashtëzakonshme sigurie në lidhje me shëndetin, si periudha e karantinimit fillestar prej 14 ditësh për aplikuesit;
- furnizim me mjete mbrojtëse i hapësirave të posaçme për zyra;
- ndryshim i metodës së punës për regjistrimin për të bërë të mundur që në qendrat e regjistrimit të ketë më pak aplikues të pranishëm dhe koha e qëndrimit ballë për ballë të jetë më e shkurtër;
- caktim i një autoriteti të ri të posaçëm (p.sh. ambiente recepcioni).

Komisioni Evropian përcaktoi në direktivat e tij për COVID-19 në lidhje me azilin se “edhe nëse ka vonesa, **shtetasit e vendeve të treta që aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare duhet që të regjistrojnë aplikimin e tyre para autoriteteve dhe të kenë mundësi që t’i depozitojnë ato.**”⁽²⁾ Përveç kësaj, në interpretimin e komisionit duhet të ekzistojë mundësia që Shtetet Anëtare⁽³⁾ ta zgjatim limitin kohor për regjistrimet deri në dhjetë ditë pune:

për një periudhë të kufizuar kohe, ku në praktikë është shumë e vështirë që autoritetet kombëtare të respektojnë limiton kohor prej tri ose gjashtë ditësh për regjistrimin si pasojë e situatës së COVID-19 në përputhje me pikën 6(5) të Direktivës për Procedurat e Azilit. Megjithatë, komisioni thekson se “sido që të jetë, çdo vonesë në regjistrimin e aplikimeve nuk duhet të cenohet të drejtat e aplikuesve sipas Direktivës për Kushtet e Pranimit, të cilat zbatohen që nga bërja e aplikimit⁽⁴⁾.”

(2) [Komunikimi nga Komisioni Covid-19](#): Udhëzues lidhur me implementimin e masave përkatëse të BE në fushën e procedurave të azilit dhe kthimit, si edhe të rivendosjes, Bruksel, 16 prill 2020 C(2020) 2516 përfundimtare, f.3 (theksi është shtuar).

(3) Shtet Anëtar është një shtet që është anëtar i Bashkimit Evropian.

(4) [Komunikimi nga Komisioni Covid-19](#): Udhëzues lidhur me implementimin e masave përkatëse të BE në fushën e procedurave të azilit dhe kthimit, si edhe të rivendosjes, Bruksel, 16 prill 2020 C. 2516 përfundimtare, f.4.



Një përshkrim i detajuar i fazave të ndryshme të bërjes, regjistrimit dhe depozitimit të një aplikimi për mbrojtje ndërkombëtare mund të gjendet në *Udhëzues praktik i EASO-Frontex: Qasja në procedurën e azilit* ⁽⁵⁾.

Në kontekstin e situatës së COVID-19, shumica e Shteteve të BE+ vazhduan të kryejnë aktivitete regjistrimi duke zbatuar masa sigurie dhe zgjidhje alternative. Për shkak të mbylljes de facto të kufijve ndërkombëtarë, numri i mbërritjeve të reja dhe i regjistrimeve pasuese ra thuajse përgjysmë ⁽⁶⁾. Qendrat e recepcioneve zbatuan masa shëndeti dhe sigurie, si kontrole mjekësore, karantinë, triazh, procese dezinfektimi etj. Në shumicën e rasteve, procedurat e regjistrimit u bënë nga policia dhe autoritetet e rojës kufitare ose brenda qendrave të recepcionit ku aplikuesit ishin tashmë të pranishëm fizikisht. Disa shtete të BE+ përdorën metodën e regjistrimit paraprak, i cili ndihmon në organizimin e regjistrimit dhe/ose depozitimit të vërtetë. Megjithatë, nocioni i “regjistrimit paraprak” nuk përmendet në Direktivën e Procedurave të Azilit ⁽⁷⁾ dhe nuk ndryshon afatet kohore brenda të cilave bëhet regjistrimi (i vërtetë) dhe jepet mundësia për depozitimin.

Praktikat e mira të identifikuara në lidhje me menaxhimin e COVID-19.

- Shkurtimi i orëve të punës dhe procedurat më të shkurtra për regjistrimin e aplikimeve për të shmangur radhët dhe për të ndihmuar distancimin social për paraqitjen e aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare nëpërmjet postës ose onlajn.
- Depozitimi i një aplikimi përbëhet nga dërgimi i një dosjeje aplikimi të nënshkruar te autoriteti i azilit me anë të postës, brenda një afati kohor të përcaktuar (p.sh. 21 ditë) nga dita e regjistrimit të aplikimit.
- Pranimi i regjistrimeve të bëra nga rojat kufitare dhe/ose autoritetet e recepcionit pa kopjimin e këtyre regjistrimeve nga autoriteti i azilit, duke rritur kështu kapacitetet e regjistrimit.
- Zhvillimi i formularëve onlajnë për t’u plotësuar nga aplikuesit për të marrë një ftesë (ditë dhe orë e caktuar) për të ardhur në qendër dhe për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare.

⁽⁵⁾ EASO-Frontex, *Udhëzues praktik: Aksesi në procedurën e azilit*, 2016.

⁽⁶⁾ Komunikatë për Shtyp nga EASO, ‘COVID-19: Aplikimet për azil ranë 43% në mars’, 30 prill 2020

⁽⁷⁾ [Direktiva 2013/32/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 qershorit 2013](#) për procedurat e përbashkëta për dhënie dhe tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare (e ndryshuar).



- Aplikuesit duhet të regjistrohen (të fotofohen dhe t'u merren shenjat e gishtave) në një qendër recepcioni, dhe gjatë këtij procesi jepet një vërtetim ardhjeje. Leja për të qëndruar gjatë procedurës së azilit jepet nga autoritetet. Të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me të drejtat dhe detyrimet i jepen aplikuesit me shkrim.
- Ruajtje e pikave të regjistrimit për raste specifike, p.sh. për aplikuesit të cilët, për shkak të rrethanave të tyre personale, e bëjnë vetë depozitimin.

III. Sigurimi i informacionit

Nëse ndodh ndonjë ndryshim në lidhje me procesin e depozitimit të aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare (në lidhje me formatin, vendndodhjen, autoritetin e caktuar), ky informacion do të bëhet publik dhe do t'u vihet në dispozicion atyre autoriteteve që ka të ngjarë të marrin aplikimet ⁽⁸⁾. Këto ndryshime mund të lidhen me masat emergjente (të përkohshme) të prezantuara në lidhje me COVID-19 (ndryshim i orarit të punës, kufizim i qasjes për publikun, mundësi e kontakteve në distancë nëpërmjet telefonit) ose prezantim i metodave dhe mjeteve të reja të regjistrimit. Grupi më i rëndësishëm i synuar janë nëpunësit e kontaktit të parë të zbatimit të ligjit, si policia, rojat kufitare, autoritetet e emigracionit dhe personeli i burgjeve, të cilët janë në pozicionin më të mirë për t'u dhënë direkt informacion shtetasve të vendeve të treta të cilët shprehin dëshirën për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare. Gjithashtu, është e nevojshme që të informohet publiku i gjerë në lidhje me ndryshimet përkatëse, nëpërmjet një fushate onlajn në faqet qeveritare publike të internetit, dhe që palët më të rëndësishme të mbahen të informuara, si organizatat e këshillimit dhe organizatat e shoqërisë civile që i ndihmojnë aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare.

Në rast se ndodhin ndryshime të rëndësishme në strukturën dhe vendet e procesit të regjistrimit, Shtetet Anëtare të BE+ duhet të marrin në konsideratë nisjen e një fushate informimi duke përdorur postera, banera, materiale audiovizive, infografikë dhe forma të tjera të komunikimit vizual. Deri në atë masë që është e mundur, këto materiale duhet të shfaqen në ato vende ku shtetasit e vendeve të treta u nevojiten.

Në varësi të organizimit kombëtar, **sigurimi i informacionit bëhet brenda një zyre regjistrimi dhe/ose qendre recepcioni**. Situata e krijuar nga masat e marra për COVID-19 në mars 2020 shpesh kanë rritur rolin e qendrave të recepcionit në procedurën e azilit. Në qendrat e recepcionit, informacioni jepet ose nga autoritetet kompetente, ose nga organizatat partnere, si OJQ-të ose organizatat e shoqërisë civile. Sigurimi i informacionit nga një OJQ ose një organizatë e shoqërisë civile zakonisht bazohet në partneritetin formal të lidhur mes autoriteteve të shteteve dhe organizatës në fjalë. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se edhe në ato raste ku ekziston ky partneritet, përgjegjësia për ta siguruar atë informacion u takon vetëm autoriteteve shtetërore.

Sipas pikës 12(1)(a) të Direktivës për Procedurat e Azilit, informacioni që duhet dhënë përfshin:

- procedura që duhet ndjekur;
- të drejtat dhe detyrimet e aplikuesit gjatë procedurës;
- pasojat e mundshme të moszbatimit të detyrimeve dhe mosbashkëpunimit me autoritetet;

⁽⁸⁾ Pika 6(1) nënparagrafi i tretë, Direktiva për Procedurat e Azilit.

- afatet kohore që zbatohen;
- mjetet që kanë në dispozicion për përmbushjen e detyrimeve për të paraqitur elementët e nevojshëm për të mbështetur aplikimin, siç tregohet te pika 4 e direktivës për kualifikimin ⁽⁹⁾;
- pasojat e një tërheqjeje të qartë ose të nënkuptuar të aplikimit.

Këto kërkesa ligjore janë operacionalizuar në *Udhëzimet e EASO për procedurën e azilit: standardet dhe treguesit operacionalë* ⁽¹⁰⁾.

Sigurimi i informacionit brenda qendrave të recepcionit mund të bëhet me gojë ose me shkrim (ose të dyja) dhe nëpërmjet shumë formave, si për shembull sesion në grup ose individual.

Është e rëndësishme të sigurohemi që informacioni rreth procedurës dhe rastit të tyre individual të jetë kuptuar nga aplikuesi. Në këtë kontekst, duhet të merren parasysh të mëposhtmet:

- në rastet ku informacioni jepet me shkrim, mesazhi shprehet në mënyrë të qartë dhe joteknike dhe aty ku është e mundur, në një gjuhë që aplikuesi e kërkon.
- aty ku është e nevojshme, informacioni jepet gjithashtu me gojë në një gjuhë që aplikuesi e kupton.
- kur informacioni jepet me gojë, autoriteti sigurohet që aplikuesi ta ketë kuptuar informacionin që i është dhënë.
- informacioni jepet në një mënyrë që merr parasysh nevojat e veçanta dhe rrethanat individuale të aplikuesve.

⁽⁹⁾ [Direktiva 2011/95/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 2011](#) Për standardet e kualifikimit të shtetasve nga vendet e treta ose të personave pa shtetësi si përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare, për një status refugjati uniform ose për personat që kanë të drejtë të përfitojnë mbrojtje plotësuese dhe për përmbajtjen e mbrojtjes së dhënë (e ndryshuar).

⁽¹⁰⁾ Shiko standardin 22 (dhe treguesit e mëtejshëm) të EASO, [Udhëzime për procedurën e azilit: standardet dhe treguesit operacionalë](#), 2019.

IV. Regjistrimi paraprak (dhe sistemet e takimit)

Nocioni i “regjistrimit” paraprak nuk ekziston në Sistemin e Përbashkët për Procedurën e Azilit. Përdoret nga disa Shtete të BE+ për të lehtësuar regjistrimin e vërtetë dhe/ose procesin e depozitimit. Gjatë regjistrimit paraprak, shpesh lidhen takime për regjistrimin e vërtetë dhe/ose depozitimin. Meqenëse nocioni i regjistrimit paraprak nuk ka bazë ligjore, limitet kohore të zakonshme për regjistrimin e bërjes së një aplikimi dhe për dhënien e mundësisë për të depozituar një aplikim mbeten të pandryshuara.

Duhet theksuar se limitet kohore të Rregullores së Dublinit III ⁽¹¹⁾ fillojnë menjëherë sapo depozitohet një aplikim për mbrojtje ndërkombëtare në Shtetin Anëtar. Depozitimi sipas Rregullores së Dublinit III reflekton pikën 6 të Direktivës së Procedurave të Azilit dhe përkufizohet në pikën 20(2) të Rregullores së Dublinit III:

Një aplikim për mbrojtje ndërkombëtare konsiderohet i depozituar pasi një formular i paraqitur nga aplikuesi ose një raport i përgatitur nga autoritetet ka arritur autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar në fjalë. Në rastin kur një aplikim nuk bëhet me shkrim, koha e mbetur mes deklaratës së qëllimit dhe përgatitjes së një raporti duhet të jetë sa më e shkurtër që është e mundur.

Jo vetëm nga kjo masë, por edhe nga gjykimi CJEU i datës 26 korrik C-670/16, *Tsegezab Mengesteab v Bundesrepublik Deutschland*, tregohet qartë se:

një aplikim për mbrojtje ndërkombëtare konsiderohet i depozituar nëse një dokument me shkrim, i përgatitur nga një autoritet publik dhe që vërteton se një shtetas i një vendi të tretë ka kërkuar mbrojtje ndërkombëtare, ka arritur autoritetin përgjegjës për implementimin e detyrimeve që lindin nga ajo rregullore, dhe siç mund të jetë rasti, nëse vetëm informacioni kryesor që gjendet në këtë dokument, por jo ai dokument ose një kopje e tij, ka shkuar tek ai autoritet ⁽¹²⁾.

Prandaj, edhe një regjistrim paraprak, në rrethana të caktuara, mund të jetë një “depozitim” sipas Rregullores së Dublinit III.

Megjithatë, sistemet e regjistrimit paraprak bëjnë të mundur që aplikimi ose depozitimi i aplikimit të jetë në një mënyrë më të organizuar dhe më të parashikueshme. Në disa shtete të BE+, janë zhvilluar sisteme onlajn në mënyrë që aplikuesit të marrin një ftesë për të bërë një

⁽¹¹⁾ [Rregullorja \(BE\) Nr. 604/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2013](#) e cila parashikon kriteret dhe mekanizmat për të përcaktuar Shtetin Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare të paraqitur në një nga Shtetet Anëtare nga një shtetas i një vendi të tretë ose një person pa shtetësi (e ndryshuar).

⁽¹²⁾ Gjykimi CJEU i datës 26 korrik 2017, *Mengesteab v Bundesrepublik Deutschland*, Rasti C-670/16, par. 101- 103.



aplikim personalisht në një qendër pranimit. Në këtë mënyrë shmangen grumbullimet në masë dhe të çorganizuara në qendrën e pranimit. Sistemi i takimeve onlajn bën të mundur organizimin e procesit të aplikimit/depozitimit/regjistrimit brenda qendrës së pranimit në një mënyrë që respekton

distancimin social. Mund të thuhet se formulari onlajn është i disponueshëm vetëm nga shteti i territorit. Aplikuesve u kërkohet të dërgojnë fotografitë e tyre dhe që dokumentet të skanohen dhe të paraqiten, duke mundësuar përcaktimin e datës së ftesës. Formulari i internetit bën të mundur gjithashtu dallimin e nevojave specifike. Zakonisht familjet ftohen së bashku. Pasi është bërë depozitimi i aplikimit në qendrën e pranimit, aplikuesit marrin një vërtetim të aplikimit të tyre.

V. Shenjat e gishtave në Eurodac

Shtetet Anëtare në detyrimin të regjistrojnë shenjat e gishtave të aplikuesve prej të paktën 14 vjetësh sa më shpejt të jetë e mundur, dhe t'i transmetojnë këto shenja gishtash, së bashku me informacionet e specifikuar në pikën 11 të Rregullores Eurodac, te sistemi Eurodac Central. Ky detyrim është përcaktuar në pikën 9(1) të rregullores Eurodac ⁽¹³⁾.

Detyrimi për të regjistruar dhe transmetuar shenjat e gishtave, edhe në mes të pandemisë COVID-19, theksohet gjithashtu nga udhëzimet e sipërpërmendura të Komisionit:

Pika 9(2) e Rregullores Eurodac parashikon që, aty ku nuk është e mundur të merren shenjat e gishtave të një aplikuesi për shkak të masave të marra për të siguruar shëndetin e tij ose mbrojtjen e shëndetit publik, Shtetet Anëtare duhet t'i marrin dhe t'i dërgojnë këto shenja gishtash sa më shpejt të jetë e mundur, dhe jo më vonë se 48 orë pasi këto arsye shëndetësore nuk janë më të rëndësishme.

Duhet të merren shenjat e gishtave të të gjithë shtetasve të vendeve të treta, të cilët janë nën detyrimin për të dhënë shenjat e gishtave, duke garantuar ndërkohë mbrojtjen e shëndetit publik ⁽¹⁴⁾.

Rregullorja Eurodac lejon njëfarë vonese në regjistrimin dhe transmetimin e shenjave të gishtave te Sistemi Qendror kur ekzistojnë kushte të caktuara, si për shembull mbrojtja e shëndetit publik. Në kontekstin e shpërthimit të Covid-19, disa shtete anëtare kanë vendosur që të ruajnë regjistrimin dhe paraqitjen e aplikimeve të reja, por të vonojnë marrjen e shenjave të gishtave. Kjo praktikë bazohet në derogimin e lejuar nga pika 9(2) e Rregullores Eurodac.

Eurodac është burimi i përbashkët i informacionit për identifikimin e një rasti të Dublinit. Në rastin kur një person aplikon për mbrojtje ndërkombëtare, databaza lejon që Shtetet Anëtare të shohin aplikimet e mëparshme për mbrojtje ndërkombëtare në Shtetet e tjera Anëtare, të transmetuara në Eurodac sipas pikës 9 të Rregullores Eurodac.

⁽¹³⁾ [Rregullorja \(BE\) Nr. 603/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2013 për themelimin e 'Eurodac'](#) Për themelimin e "Eurodac" për krahasimin e gjurmëve të gishtave me synimin e zbatimit të efektshëm të Rregullores (BE) 604/2013 e cila përcakton kriteret dhe mekanizmat për përcaktimin e Shtetit Anëtar përgjegjës për shqyrtimin aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare të paraqitur në një Shtet Anëtar nga një shtetas i një vendi të tretë ose nga një person pa shtetësi dhe për kërkesat për krahasim me të dhënat e Eurodac të paraqitura nga autoritetet e zbatimit të ligjit të Shteteve Anëtare dhe Europol për qëllime të zbatimit të ligjit dhe për të ndryshuar Rregulloren (BE) 1077/2011 e cila krijon një agjenci evropiane për menaxhimin operacional në shkallë të gjerë të sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në një hapësirë lirie, sigurie dhe drejtësie (e ndryshuar).

⁽¹⁴⁾ [Komunikimi nga Komisioni Covid-19](#): Udhëzues lidhur me implementimin e masave përkatëse të BE në fushën e procedurave të azilit dhe kthimit, si edhe të rivendosjes, Bruksel, 16 prill 2020 C. 2516 përfundimtare, f.15.

Mosmarrja e shenjave të gishtave do të ndikojë rëndë te procedura e Dublinit, si në atë moment, ashtu edhe në të ardhmen. Nëse nuk regjistrohen shenjat e gishtave në Eurodac, autoritetet e Shteteve Anëtare nuk do të jenë në gjendje të verifikojnë që një aplikim është depozituar diku tjetër. Nëse një aplikuesi do t'i jepej mundësia që të ndiqte një procedurë aplikimi në një shtet tjetër, kjo do të dobësonte sistemin. Për këtë arsye përdoret Eurodac si një tregues për të paraqitur kërkesat e marrjes në ngarkim ose kthimit, duke u bazuar në informacionet e aplikimeve të mëparshme ose të kalimeve jo të rregullta të kufirit, dhe shërben si një mjet i fuqishëm vërtetimi kur paraqiten këto kërkesa. Pa rezultatet e kërkimit të Eurodac, këto kërkesa të marrjes në ngarkim ose kthimit ka më tepër të ngjarë të jenë të pasuksesshme. Përveç kësaj, limitet kohore janë më të gjata për kërkesat e marrjes në ngarkim ose kthimit pa ndihmën e Eurodac, dhe kjo bën që procesi të vonohet.

Për të shmangur vonesat e mëdha në procedime dhe për të garantuar qasjen e efektshme dhe të shpejtë në procedurat për aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare, është e rëndësishme të vazhdohet regjistrimi i shenjave të gishtave të aplikuesve me Eurodac kategoria 1, të transmetohen informacionet e nevojshme në Sistemin Qendror Eurodac, dhe të krahasohen shenjat e gishtave në Eurodac.

Mbyllja e kësaj procedure sa më parë bën të mundur që autoritetet të dallojnë herët rastet e mundshme të Dublinit. Kjo do të bëjë të mundur nisjen sa më parë të procedurës së Dublinit, do të kontribuojë në një procedurë më të suksesshme të Dublinit dhe do t'i japë mundësi aplikuesit të ketë qasje më herët në sistemin e azilit.

Gjatë pandemisë COVID-19, janë identifikuar disa praktika të mira në Shtetet Anëtare në raport me vazhdimin e marrjes së gishtave të aplikuesve:

- vendosja e më shumë pajisjeve për leximin e shenjave të gishtave në zyrat ku aplikuesit mund të regjistrohen (si për shembull, në pikat e hyrjes, rajonet e policisë, zyrat e policisë etj.);
- veshja e mjeteve personale mbrojtëse, si syze dhe maska për të parandaluar përhapjen e mundshme të virusit;
- përdorimi i dezinfektuesve të duarve para se të merren shenjat e gishtave;
- pastrimi dhe dezinfektimi i pajisjeve të leximit të shenjave të gishtave para dhe pas çdo përdorimi;
- përdorimi i plexiglass për të shmangur kontaktin direkt gjatë marrjes së shenjave të gishtave;
- ruajtja e distancës së rekomanduar dhe dhënia e udhëzimeve nga larg;
- përdorimi i tabelave të informacionit, piktogrameve ose mjeteve të tjera shpjeguese për të mësuar mënyrën se si duhet të vendosen gishtat në pajisje që procesi të kryhet me sukses;



Duhet pasur parasysh se, që të aplikohet Rregullorja e Dublinit III, kushti i domosdoshëm është depozitimi i aplikimit, jo marrja e shenjave të gishtave. Me fjalë të tjera, procedura e Dublinit nuk fillon me regjistrimin e shenjave të gishtave, dhe Rregullorja e Dublinit III zbatohet edhe kur nuk janë marrë shenjat e gishtave.

VI. Vetëregjistrimi

Disa shtete të BE+ kanë zhvilluar sisteme regjistrimi që u japin mundësi aplikuesve të regjistrohen vetë në terminale ose kabina të veçanta regjistrimi, të cilat ndodhen në ambientet e administratave. Ky organizim bën të mundur të bëhen disa regjistrime njëkohësisht, me ndihmë minimale nga një nëpunës i caktuar dhe në disa raste pa pasur nevojë të jetë i pranishëm një përkthyes.

Ky proces mund të përmirësohet më tej duke e bërë procesin më interaktiv, për të marrë përsipër një pjesë të rolit që ka nëpunësi i regjistrimit për t'i ndihmuar aplikuesit që të gjejnë informacione përkatëse në gjuhën e tyre dhe që të plotësojnë formularët.

Janë duke u bërë studime të vazhdueshme për përdorimin e Inteligjencës Artificiale (AI) që chatbot- et të lehtësojnë procesin e regjistrimit. Chatbot-et, të cilat simulojnë bisedat me njeriun, janë duke u përdorur tashmë në disa shtete në fushën e emigracionit. Përdorimi i chatbot-eve mund t'i ndihmojë aplikuesit gjatë procesit të vetëregjistrimit dhe shton një element të verifikimit të të dhënave për të garantuar vendosjen e të dhënave të sakta nga aplikuesi ose për t'i ndihmuar aplikuesit me kërkesat e mëtejshme. Chatbot-i mund të përdoret për t' ndihmuar aplikuesit të gjejë informacion përkatës në gjuhën e tij dhe mund të përdoret si kanal për t'iu përgjigjur automatikisht pyetjeve të bëra shpesh. AI mund të ndihmojë më tej procesin e vetëregjistrimit duke aktivizuar automatikisht veprime të brendshme përkatëse (si lënia e takimit për intervistën ose rezervimi i një përkthyesi) për të zëvendësuar punën manuale Chatbot-i mund t'i ndihmojë aplikuesit duke bërë kërkesa (p.sh. kërkesat për dokumentet e mëtejshme) kur është e nevojshme.

Vetëregjistrimi i jep mundësi aplikuesit që të regjistrojë vetë sa më shumë informacion që është e mundur nëpërmjet një platforme digjitale që disponohet në disa gjuhë dhe që ndodhet në qendrat e recepcionit. Ai ka për qëllim të ndihmojë intervistën për regjistrimin dhe jo ta zëvendësojë komplet atë. Një supervizor është i pranishëm ndërsa bëhen vetëregjistrimet. Supervizori mund të monitorojë njëkohësisht disa regjistrime.

Procesi i vetëregjistrimit pakëson kohën që kalohet ballë për ballë nga nëpunësit e regjistrimit dhe përkthyesit. Kjo e bën procesin e përgjithshëm më pak të kushtueshëm, por edhe ndihmon në implementimin e masave të distancimit social, të cilat janë vendosur gjatë shpërthimit të COVID-19. Fushat e strukturuar të përdorura nga mjeti bëjnë të mundur edhe përkthimin automatik, duke pakësuar kohën që duhet të kalojë një përkthyes në një rast.

Gjithashtu, është i rëndësishëm fakti se vetëregjistrimi përforcon përgjegjësinë dhe aftësinë zotëruese të aplikuesit mbi informacionin e dhënë, duke rritur ndërkohë besimin te procedura. Vlerësimet kanë treguar se cilësia e informacionit të dhënë nëpërmjet vetëregjistrimit nuk është më e paktë sesa kur regjistrimi bëhet ballë për ballë.

VII. Mbledhja e të dhënave në distancë

Mbledhja e të dhënave është një aktivitet i rëndësishëm i procesit të regjistrimit dhe shpesh bëhet personalisht gjatë një interviste regjistrimi. Megjithatë, në varësi të organizimit kombëtar, të dhënat personale të një aplikuesi mund të merren edhe në distancë, nëpërmjet një **interviste onlajn** ose nëpërmjet një **formulari onlajn, me email ose me postë**.

Për të garantuar plotësinë, saktësinë dhe besueshmërinë e informacionit të dhënë, si regjistrimi në distancë, ashtu edhe ai ballë për ballë mund të kombinohen duke ndihmuar njëri-tjetrin. Përveç kësaj, disa të dhëna kërkojnë praninë fizike të aplikuesit, në veçanti në lidhje me të dhënat biometrike. Në sistemet e kombinuara, të dhënat personale mund të mblidhen në distancë (me email ose postë), ndërsa të dhënat biometrike merren personalisht në zyrën e regjistrimit. Mbledhja e të dhënave në distancë mund të ndihmojë më tej për të përgatitur dhe shkurtuar intervistën e regjistrimit ballë për ballë.

Mbledhja e të dhënave në distancë duhet të bëhet duke marrë parasysh aspektet e mëposhtme:

- Sigurimi i informacionit duhet të bëhet para mbledhjes së të dhënave në distancë, në një gjuhë që aplikuesi e kupton ose me shërbimet e një përkthyesi. Përveç informacionit që duhet dhënë sipas pikës 12) 1(a) të direktivës së procedurave të azilit, aplikuesi duhet të informohet gjithashtu për specifikat e procesit të mbledhjes së të dhënave në distancë, pra cila është arsyeja e përdorimit të këtij procesi dhe masat mbrojtëse përkatëse që janë marrë.
- Duhet të vlerësohet sa e përshtatshme është metoda e mbledhjes së të dhënave në distancë, duke marrë parasysh rrethanat individuale të aplikuesit. Në këtë aspekt, duhet t'u kushtohet rëndësi e veçantë aplikuesve vulnerabël ose aplikuesve me nevoja të veçanta procedurale.

Duke u bazuar në praktikat e Shteteve të BE+, mbledhja e të dhënave në distancë mund të paraqesë karakteristikat e mëposhtme:

- Administratat e azilit përdorin deri në shkallën më të gjerë të mundshme të dhënat që mund t'i marrin tashmë, p.sh. brenda qendrave të recepcionit, për të pakësuar sasinë e informacionit që duhet të merret në distancë.
- Për të dhënat e dërguara me postë nga aplikuesit, regjistrimi/depozitimi mund të shkarkohet onlajn në disa gjuhë. Mund të kërkohet që të dhënat personale të dërgohen duke përdorur një letër të regjistruar me një faturë kthimi.
- Për të dhënat e paraqitura onlajn nga aplikuesit, të dhënat vendosen në një faqe interneti të sigurt (ose në një formular uebi), e cila mund të hapet vetëm në Shtetin Anëtar në fjalë.

Pasi formular të jetë plotësuar, aplikuesi merr një email ose një dokument që konfirmon paraqitjen e të dhënave personale.

- Mjetet ndihmëse interaktive në dispozicion (p.sh. një bisedë onlajn ose chatbot) për t'i ndihmuar aplikuesit me plotësimin e formularit.
- Në organizimet që kombinojnë mbledhjen e të dhënave në distancë dhe atë onlajn, pasi të dhënat personale të jenë paraqitur (me postë ose onlajn), konfirmimi i kuponit që i dërgohet aplikuesit do të tregojë datën dhe orën për një takim në zyrën e regjistrimit, me qëllim që aplikuesi t'i nënshtrohet një hapi të dytë të mbledhjes së të dhënave.

Kur mbledhen të dhënat në distancë, duhen pasur parasysh masat mbrojtëse minimale të mëposhtme:

- Jepet një mundësi që aplikuesi të paraqesë dokumentet përkatëse (karta identiteti, certifikatat) si elektronikisht, ashtu edhe fizikisht nëse është e nevojshme, tek autoritetet.
- Mënyra e përcaktuar e komunikimit duhet të jetë e përshtatshme për mbrojtjen/konfidencialitetin e të dhënave në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave. Kjo do të thotë të sigurohemi për integritetin fizik të kutive postare dhe të sigurojmë mbrojtje kibernetike të komunikimeve elektronike (kuti postare, chat-et, aplikimet onlajn etj.).
- Në rast se mbledhja e të dhënave në distancë përbën depozitimin formal të një aplikimi, duhet të ketë një mënyrë të qartë për regjistrimi e datës së depozitimit për të përcaktuar afatet procedurale. Gjithashtu, është e rëndësishme që autoriteteve kombëtare t'u jepet (mundësisht) një konfirmim/certifikatë elektronike për aplikuesin në paraqitjen e aplikimit me qëllim që të vërtetohet e drejta e tij për të qenë aplikues për mbrojtje kombëtare. Kjo është e rëndësishme në rastet kur aplikuesit nuk kanë marrë konfirmim të mëparshëm të regjistrimit të bërjes së aplikimit. Autoritetet duhet të kenë një sistem të përshtatshëm elektronik për menaxhimin e dokumenteve, për t'u siguruar që aplikimet të mos anashkalohen dhe që aplikimet të përpunohen në mënyrë transparente (p.sh. kuti postare të posaçme për aplikimet e dërguara onlajn, sistem gjurmimi/shpërndarjeje për aplikimet onlajn, lajmërimet të brendshme që njoftojnë për afatet që po afrohen).
- Rastet duhet të vlerësohen secili më vete për t'i siguruar që mbledhja e të dhënave në distancë të përdoret vetëm për rastet e përshtatshme. Duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë aplikuesve që kanë nevojë të veçanta procedurale.

Në disa situata, mund të jetë mirë që intervista në distancë të ndërpritet. Për ndihmë me organizimin e intervistave në distancë, ju lutem të shihni [Rekomandimet e EASO për kryerjen e intervistës personale në distancë](#), që është publikuar në maj 2020 dhe që deri në një masë më të gjerë, mund të aplikohet edhe në kontekstin e një interviste regjistrimi.

VIII. Roli i madh i qendrave të recepcionit në procesin e regjistrimit

Qendrat e recepcionit mund të mbështetin procedurën e regjistrimit në formën e **dhënies së asistencës dhe këshillave për aplikuesit**. Kjo mbështetje mund të jetë në formën e dhënies së ndihmës për të plotësuar formularin e regjistrimit, dërgimin e formularit tek autoriteti kompetent i regjistrimit, mbledhjen e dokumenteve përkatëse dhe të disponueshme, bërjen e fotokopjeve etj. Ndihma dhe këshillat jepen së bashku me shërbimet e një përkthyesi ose ndërmjetësi kulturor.

Roli i qendrave të recepcionit mund të shkojë përtej ndihmës së aplikuesve dhe mund të kërkojë që **qendra e recepcionit të drejtojë procedurën e regjistrimit**. Shkalla e rolit të qendrës së recepcionit në procedurën e regjistrimit mund të ndryshojë në varësi të organizimit kombëtar.

Disa shtete të BE+ parashikojnë se shumica, për të mos thënë të gjitha, aktivitetet e regjistrimit bëhen nga autoriteti i recepcionit. Autoriteti i recepcionit ndërmerr mbledhjen e të dhënave personale, futjen e aplikimit në dosje, bërjen e fotografisë, marrjen e shenjave të gishtave dhe të dhënave të tjera biometrike, dhe dhënien e dokumentit/certifikatës zyrtare të regjistrimit. Më pas, autoritetet e recepcionit ia përcjellin aplikimin autoritetit kombëtar të azilit.

Masat në lidhje me situatën e COVID-19 kanë detyruar disa Shtete të BE+ të rrisin rolin e qendrave të recepcionit në procesin e regjistrimit dhe të pakësojnë marrjen për herë të dytë të informacioneve të mbledhura nga qendrat e recepcionit dhe autoritetet e azilit. Bashkëpunimi më i ngushtë mes qendrave të recepcionit dhe autoriteteve të azilit në një numër shtetesh ka çuar në rritje të besimit në procedurat e njëri-tjetrit. Kjo mund të krijojë bazën për unifikimin e mëtejshëm të proceseve të regjistrimit në të ardhmen.

Si përfundim, në rastet kur organizimi kombëtar parashikon mundësinë e bërjes së intervistës së regjistrimit në distancë, intervista në distancë është ajo që preferohet në qendrat e recepcionit. Përveç kësaj, qendrat e recepcionit ka më shumë të ngjarë që të kenë mundësi të sigurojnë një dhomë të posaçme për videokonferencën, e cila siguron ruajtjen e konfidencialitetit dhe pajtueshmërinë me standardet bazë për cilësinë e intervistës. Gjithashtu, stafi i recepcionit mund të kontrollojë se kush merr pjesë në videokonferencë, të verifikojë identitetin e aplikuesit dhe të japë pajisjet IT dhe ndihmën e nevojshme.